**VENDIM**
**Nr.72, datë 20.10.2006**

**PËR PEZULLIMIN E ZBATIMIT TË METODOLOGJISË PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË LIDHJEVE TË REJA NË RRJETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar me ligjin nr.9512, datë 10.4.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "KESH" sh.a. për shtyrje të afatit të zbatimit të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.36, datë 12.6.2006 "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e tarifave të lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike",

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për shtyrje të afatit të aplikimit të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.36, datë 12.6.2006 "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e tarifave të lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike".
2. Zbatimi i vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.36, datë 12.6.2006 "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e tarifave të lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike", pezullohet deri në një vendim të dytë të Bordit të Komisionerëve.
3. Ngarkohet KESH që, duke filluar nga data 20.10.2006, KESH sh.a. të zbatojë vendimin nr.17, datë 19.12.2001 "Për miratimin e udhëzimit mbi furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj"
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
**Bujar Nepravishta**